



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, merr këtë

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi ( Ruzhdi ) Fetahut dhe Magbule ( Shahin ) Sadrisë.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
  1. Pjesa e parcelës kadastrale nr. 02758-19, me sip. 623 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P - 71914059-02758-19, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 35-1299, të dt. 29.06.2010.
  2. Ndërsa prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale nr. 10490-0, me sip. 4045 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P - 71914059-10490-0, në pronësi të Nazmi ( Ruzhdi ) Fetahut, dhe pjesa e parcelës nr. 00363-0, me sip. 1198 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P- 71914066-00363-0, në pronësi të Magbule ( Shahin ) Sadrisë, me destinim infrastrukturë rrugore të planifikuar sipas Planit rregullues "Sofalia" 2016-2024, i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr.31-247790, të dt. 04.10.2016.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 35-1299, të dt. 29.06.2010.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-462/01-134225/23, më 29.06.2023

KRYESUESI I MBLEDHJES SË KUVENDIT  
AJET BRAJSHORI



## Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr.350/02-101763/22, dt. 22.03.2023 dhe Informimit të korigjimit të gabimit teknik, nr. 05. nr. 350/02-101763/22, dt.27.04.2023, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 2758-19, sip. 623m<sup>2</sup>, ZK Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, të cilat gjenden në kuadër të bllokut urban “b-06”, sipas Planit rregullues “Muhaxhirët”, i miratuar me Vendimin nr. 01nr.35-1299, dt.29.06.2010, dhe pjesa e parcelës kadastrale, nr. 10490-0, me sip. 4410m<sup>2</sup>, ZK Prishtinë, në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut, me destinim infrastrukturë rrugore të planifikuar, dhe parcela nr. 363-0, me sip. 1198 m<sup>2</sup>, ZK Sofali, me destinim infrastrukturë rrugore të planifikuar.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Muhaxhirët”, i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-1299, dt. 29.06.2010. Parcela nr. 2758-19, Zona kadastrale Prishtinë, shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa pjesa e parcelës nr. 10490-0, me sip. 4410m<sup>2</sup>, ZK Prishtinë, sipas Planit rregullues “Sofalia” 2016-2024, i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 031-247790, dt. 04.10.2016, shtrihet në infrastrukturë rrugore të planifikuar, dhe parcela nr. 363-0, ZK Sofali me destinim në infrastrukturë rrugore të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.